

STATUTI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

LEMAK Shpk



STATUTI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

LEMAK Shpk

I. KRIJIMI, FORMA, EMERTIMI, OBJEKTI

NENI 1

Sot me date 10.02.2022, krijohet Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "LEMAK" Sh.p.k., me seli ne adresen Tirane ALBANIA , Bashkia Tirane,Njesia bashkiake Nr 9 . Rruga "Dervish Hatixhe" Kopleksi i ri Golden II, Hyrja I,Kati 7,Ap nr.37,Shkalla 3. Përballe ONX Tirana, 1000, Albania,eshte krijuar sipas ketij statuti I hartuar dhe i nenshkruar nga Ortaku i Vetem i saj z.Kamel Alla.

NENI 2

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj tregtare ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi,te , te ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008, " Per shoqerite tregtare" dhe te ligjit Nr.9723, date 03.05.2007 "Per Q.K.R dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare si dhe ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi. Shoqeria ka vulen dhe emrin e saj.

NENI 3

Emertimi i Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar eshte "LEMAK" Sh.p.k.

NENI 4

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "LEMAK " Sh.p.k. do te kete per objekt te veprimtarise se saj:

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushat e meposhtme:

Aktivitet ne fushen e prodhimit te materjaleve te ndertimit,nxerrjes ,shfrytezimit dhe perpunimit te burimeve minerale,mermereve,graniteve etj.Tregtimin e materialeve te ndertimit te prodhuara nga shfrytezimi perpunimi dhe prodhimi i burimeve minerale ,mermereve graniteve etj.Importin dhe eksportin e produkteve industrialeve te materialeve te ndertimit, graniteve mermereve etj me shumice e pakice. Studimin, projektimin, konsulencen, siper marrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike te veprave me karakter shfrytezimi dhe/ose administrimi, publike dhe/ose private si: ndertimin e ndertesave publike dhe private, rrugeve, urave, tuneleve Te rrugeve,tuneleve te autostradave ose Tuneleve per HEC-e, mbikalimeve e nenkalimeve, autostradave,



traseve hekurudhore, dhe te gjitha veprave te tjera madhore, ujesjellesave, Ujrave mbitokesore dhe nentokesore per energjine dhe telekomunikacionet, ndertimin dhe rehabilitimin e veprave ujtesore, centralet, objektet turistike, objektet ushtarake, objektet e kultit, rrjetet inxhinierike, portet, aeroportet, objektet industriale, te gjitha restaurimet ne pergjithesi, rikonstruksione te veprave te artit, montimet e konstruksioneve metalike; si dhe cdo ndertim tjetër .

Prodhimi i asfaltit, betonit dhe materialeve inerte. Tregtimi dhe shumice dhe pakice i asfaltit, betonit dhe materialeve inerte. Punime ndertimi te cfaredolloji dhe rikonstruksione. Projektim, realizim dhe menaxhim te vendgrumbullimeve te mbeturinave. Germimin dhe nxjerrjen e materialeve nga burimet e veta apo nga te tretet. Huadhenie te makinerive. Germime dheu, zhvendosje te dherave. Nivelim te truallit dhe bonifikime. Punime hidraulike, ngritjen e kolonave. Prodhim dhe tregtim i materialeve prej betoni te parapergatitur (bordura, tuba betoni, puseta etj).

Kerkime dhe zbulime gjeologjike, studim, projektim, shfrytezim, perpunim, pasurim, tregtim, import eksport te mineraleve metalor, jometalor, qymyret dhe bitumet, mineraleve ndertimore dhe te gjitha llojet e tjera sipas klasifikimit te ligjit minerar ne fuqi. Import dhe eksport, tregtimi i te gjitha llojeve te makinerive qe nevojiten per kryerjen e operacioneve te punes qe ka ne object shoqeria. Kryerjen e studimeve, auditim, mbikqyrje, plane relabilitimi, raport te vleresimit te ndikimit ne mjedis, per rehabilitimin mjedisor ne zonat e demtuara. Kryerja e studimeve dhe matjeve topologjike, markshajderike ne te gjitha fushat ku kryen veprimtarine shoqeria si dhe per subjektet e tjera. Depozitim dhe tregtim bitumi.

Shfrytezim mineralesh, Kryerje Shpimesh ne thellesi, ndertime industriale, konsulence teknike, Studime ,mbikqyrje monitorime ne matjet topomarkshederike ne tunele dhe punime kapitale per infrastrukturen rrugore , hidrocentrale, nafte-gazesjelles , depo te lendeve plasese dhe objekte te tjera me karakter civil.

Projektme konsultime, vleresime ,kolaudime ,supervizues per veprimtarine e hapjes se punimeve minerare kapitale dhe dytesore, tunele dhe punime kapitale nentokesore per infrastrukture rrugore ,hidrocentrale , nafte-gazesjelles , depo te lendeve plasese dhe objekte te tjera me karakter civil. Punime me lende plasese ne siperfaqe dhe nentoke , Import - Eksport i lendeve plasese.

Tregtimi i artikujve te ndryshem industriale, ushqimore, bujqesore, konfeksione, mobilje, materiale ndertimi, automobilistike, elektrike, elektronike, me shumice dhe pakice, import-eksport. Tregtimi i makinerive, mjeteve te transportit, dhe makinerive industriale. Ndertime hidraulike dhe hidroteknike. Vepra te vecanta dhe punime speciale.

Ne fushen e minierave shoqeria do te kryeje: Studimin, zbatimin, projektimin, konsulencen, sipermarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike te minierave me karakter shfrytezimi dhe/ose administrimi publik dhe/ose privat si: ndertimin dhe shfrytezimin e minierave publike dhe private per te tera llojet e mineraleve, shfrytezimin e burimeve natyrore te ujrave minerale dhe termale; nxjerja, prodhimi, perpunimi dhe tregtimi brenda vendit e mineraleve te paperpunuara dhe te perpunuara.



3 / f a q e
[Signature]

- **Ne fushen e turizmit shoqeria do te kryeje** te gjithë veprimtarite qe parashikon ligji dhe si rrjedhoje jane ne dobi te zhvillimit te aktivitetit te shoqerise.
- **Ne fushen e transportit, shoqeria do te kryeje** te gjithë veprimtarite qe parashikon ligji dhe si rrjedhoje jane ne dobi te zhvillimit te aktivitetit te shoqerise.
- **Ne fushen e mjedisit shoqeria do te kryeje** te gjithë veprimtarite qe parashikon ligji dhe si rrjedhoje jane ne dobi te zhvillimit te aktivitetit te shoqerise.
- **Ne fushen e Energjise** ,aktivitetin e tregëtimit me pakice te karburanteve, mbajtjen e depozitave te karburanteve per efekt te aktivitetit te shoqerise per tregëtimin dhe perdorimin e karburanteve per shkak te veprimtarise se saj. Ndertimin,projektimin,zbatimin dhe/ose investimin me fondet e saj /ose te paleve te treta,te parqeve eolitike me energjine e eres, Parqeve energjitike te paneleve solare(diellore), dhe HEC-eve me energjine e ujit.

Ndertimin,projektimin,zbatimin dhe 'ose investimin me fondet e saj 'ose te paleve te treat,te parqeve eolitike me energjine e eres, Parqeve energjitike te paneleve solare(diellore), dhe HEC-eve me energji te rinovueshme hidrike.

Krijimi i BOE (Bshkim i operatoreve ekonomik) ose i Joint Venture (J.V) me kompani vendore dhe te huaja me afat te gjate e te shkurter, hapje filiali brenda e jashte vendit, cdo biznes te pershtatshem brenda kuadrit te dispozitave ligjore ne fuqi.

NENI 5

Selia ligjore e shoqerise eshte ne adresen: Tirane ALBANIA , Bashkia Tirane,Njesia bashkiake Nr 9 . Rruga "Dervish Hatixhe" Kopleksi i ri Golden II, Hyrja I,Kati 7,Ap nr.37,Shkalla 3. Përballe ONX Tirana, 1000, Albania. Ajo mund te hape filjale, dege e zyra ne te gjithë vendin,brenda territorit te Republikes se Shqiperise ,dhe jashte territorit, ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

NENI 6

Kohe zgjatja e shoqerise eshte percaktuar pa afat.

II. KAPITALI THEMELTAR

NENI 7

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 70000.00 (Shtatedhete mije) leke.

Kapitali ndahet ne 100% = 1 Kuote z.Kamel Alla

NENI 8



STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
LEMAK Shpk

[Handwritten signature in blue ink]

Me vendim te ortakut, kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet kontributeve ne para ose ne natyre. Po keshtu mund te zvogelohet kur kjo gje motivohet nga humbjet qe peson shoqeria.

NENI 9

Pjeset e kapitalit. Themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie, ndermjet familjareve berthame te familjes si dhe ndermjet paraardhesve e pasardhesve.

NENI 10

Pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transfeohen te treteve me miratim te Ortakut te Vetem. Po keshtu mund te perfshihet ne shitblerje aksionesh me shoqeri te tjera duke u kthyer ne filjale, shoqeri kontrolluese ose e kontrolluar nga nje shoqeri tjeter.

NENI 11


Ne çdo rast, transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar, duhet te vertetohet me nje akt noterial, ose me miratimin e ortakut te vetem.

III. MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI, KOMPETENCAT DHE KONTROLLI I SHOQERISE.

NENI 12

Te gjitha vendimet e shoqerise merren nga Ortaku i Vetem duke u bazuar ne dispozitat ligjore te percaktuara ne ligjin " Per shoqerite tregtare", ne lidhje me marrjen e vendimeve. **AI VENDOS VETE KRYESISHT PER KETO ÇESHTJE:**

- Merr vendime per ndryshimin e formes, emertimit, selise, kapitalit, veprimtarise se shoqerise, ndryshim ne zoterimin e kuotave te kapitalit te shoqerise, pranim te ortakeve, pjesmarrjen e shoqerise ne shoqeri te tjera dhe anasjelltas
- Miraton raportet financiare e bilancin vjetor, vendos per perdorimin e fitimit,organizimin e shoqerise dhe per prishjen e saj.
- Emerton dhe shkarkon administratorin, likujdatorin, ekspertet kontabel si dhe drejton veprimtarite e rendsishme te shoqerise.



- Emerton dhe shkarkon drejtuesin teknik te shoqerise

Marrja e vendimeve realizohet nme iniciativen e Ortakut te Vetem ose me kerkese te administratorit, te ekspertit kontabel, te cilet ne kete rast duhet t'i njoftojne Ortakut projektin dhe relacionin shpjegues 15 dite perpara takimit.

NENI 13

Shoqeria administrohet nga nje person fizik qe mund te jete vet Ortaku i Vetem ose nje person tjetër i emeruar ne kete detyre.

Administratori ka te gjitha kompetencat per te kryer veprimet e administratorit, ne interes te shoqerise dhe ne emer te saj, nepermjet kompetencave te percaktuara ne kete statut.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut te Vetem.

Kohezgjatja e mandatit te administratorit eshte per 5 (pese) vite financiare radhazi dhe mund te perseritet.

Mandati perfundon perpara ketij afati kur administratori nuk ploteson kushtet per te kryer kete detyre, jep doreheqjen ose shkarkohet me vendim te Ortakut te Vetem, a nga nje vendim gjykate.

NENI 14

Administratori i Pare i Shoqerise emerohet z.Kamel Alla.

NENI 15

Administratori eshte perjegjes, sipas rastit, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

NENI 16

Disa nga kompetencat qe i jepen administratorit jane:

- Te siguroje drejtimin e mire te veprimtarise tregetae te shoqerise.
- Te administroje pasurite e shoqerise.



- Te perfaqesojë shoqerine në mardhënie me të treta.
- Te perfaqesojë shoqerine në mardhënie me orgnet e institucionet shtetërore, para organeve gjyqësore vete ose duke autorizuar persona të tjere kompetent.
- Te kryejë veprime juridike në emër e për llogari të shoqerise me të tretet si: të lidh kontrata, të kryej veprime bankare të ndryshme si çelje llogarish, marrje kredie, transferata etj.

NENI 17

Kontrolli i veprimtarisë ekonomiko-financiare të shoqerise realizohet me vendim të Ortakut të Vetem.

IV. VITI FINANCIAR DHE LLOGARITE VJETORE

NENI 18

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht nga kjo, viti i parë financiar ka filluar ditën e themelimit të shoqerise si person juridik.

NENI 19

Llogarite vjetore, inventaret, raportet mbi veprimtarinë e vitit financiar të hartuara nga administratori dhe eksperti kontabel i autorizuar, miratohen nga Ortaku i Vetem, brenda një afati prej 6-muaj nga mbyllja e vitit financiar.

NENI 20

Bilanci vjetor i shoqerise nxirret brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës.

NENI 21

Fitimet neto të realizuara nga veprimtaria e shoqerise, mbasi të jenë zbritur të gjitha shpenzimet e kryera, detyrimet fiskale, rezerva e domosdoshme etj., i shpërndahen Ortakut ose me vendim të tij mund të përdoren për investime, nxitjen e veprimtarisë tregëtare, reklama dhe për çdo qëllim tjetër të ligjshëm dhe që i shërben shoqerise.



NENI 22

Shoqeria ka te drejten e perdorimit lirisht te fitimit dhe disponimit te pasurise se saj ne perputhje me qellimin e objektit te veprimtarise qe kryen.

NENI 23

Detyrimet qe lindim gjate ushtrimit te veprimtarise se shoqerise, ajo i mbulon nga fondi reserve ose nga shumat suplementare.

NENI 24

Shoqeria gezon te gjitha te drejatat, per mbrojtjen e pasurise se saj, te parashikuara nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

NENI 25

Maredheniet juridike ndermjet shoqerise dhe personave qe punesohen ne te rregullohen ndermjet kontratave te punes bazuar ne kodin e Punes dhe dispozitat e tjera ligjore ne fuqi.

NENI 26


Shoqeria merr persiper, te shlyej rregullisht te gjitha detyrimet e saj qe burojne nga legjislacioni per sigurimet shoqerore e shendetesore lidhur me te punesuarit e saj.

VI. PRISHJA E SHOQERISE, LIKUJDIMI

NENI 27

Shoqeria prishet perpara kohe kur:

- Rezultati ekonomik i aktivitetit te saj per disa vite radhas eshte me humbje.
- Per shkaqe te pa parashikuara shprehimisht ne ligj.
- Ne çdo rast tjeter me vendim te ortakut te vetem.



NENI 28

Shoqëria mund të shpallet në likuidim me vendim të ortakut të vetëm të saj ose nëpërmjet një vendimi nga gjykata në bazë të ligjit.

Ajo hyn në procesin e likuidimit që në momentin e marrjes së vendimit. Për realizimin e këtij procesi Ortaku ose Gjykata emerojnë një ose më shumë likuidatore, të cilët përgatisin dhe paraqesin raportin përmblyes të aktivitetit dhe pasivitetit të shoqërisë dhe bilanci përkatës.

VII. KUSHTE TË TJERA

NENI 29

Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm evidentohen në një libër të veçantë, i cili administrohet në selinë e shoqërisë.

NENI 30

Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, organ kompetent për zgjidhjen tyre është Gjykata e Rrethit ku ka selinë shoqëria, referuar legjislacionit shqiptar në fuqi.

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“LEMAK” Shpk

ORTAKU I VETËM

KAMEL ALIJA

STATUTI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

LEMAK Shpk

9 | Faqë

STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
LEMAK Shpk

